

Dr. Fehmi Pushkoll

FORMIMI I KOMITETIT NACIONAL TË SHQIPTARËVE TË KOSOVËS DHE VEPRIMTARIA E TIJ 1945—1947*

Komiteti Nacional i Shqiptarëve ishte fryt i luftës shumëvjeçare të popujve tanë që të jetojnë të vëllazëruar e të bashkuar, të lirë dhe me mirëkuptim të plotë midis tyre. Komiteti u formua duke u mbështetur në përvojën e hidhur në të kaluarën, e cila mohonte të drejtat kombëtare të një populli që përbente shumicën në këtë Krahinë, duke varrosur marrëdhëniet e ndërsjella vëllazërore dhe duke zhvilluar shovinizmin, e që njëherazi varroste dhe uzurponte lirinë e të gjithë popujve. Në një përfundim të tillë erdhi edhe udhëheqja e Kosovës dhe e Rrafshit të Dukagjinit, duke u mbështetur në parimin që shtruan klasikët e marksizmit — populli që shtyp tjetrin — nuk është as vetë i lirë. Prandaj vetëm me zgjidhjen e drejtë të çështjes kombëtare, duke u dhënë të drejta të njëjta të gjithë popujve për afirmim kombëtar e kulturor, ishte e mundshme të sigurohej liria, e cila është një dhe e pandashme për të gjithë. Formimi i Jugosllavisë Demokratike Federative dhe formimi i njëjve federale, pra edhe i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit, ishte garanci se shoqëria kishte marrë orientim të mirë, duke zhdukur hegjemoninë që ishte krijuar gjatë gjithë ekzistimit të Jugosllavisë së vjetër dhe për të gjithë ishte e qartë se edhe katastrofa shtetërore e vitit 1941 ishte rezultat edhe i shtypjes kombëtare, prandaj vëllazërimi e bashkimi dhe të drejtat e barabarta kombëtare ishin garanci se e kaluara e tillë kurrë nuk do të kthehej. Nga ky kuptim, i cili më 1945 ishte bërë realitet, u lind Komiteti Nacional i Shqiptarëve në Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit.

Komiteti Nacional i Shqiptarëve ishte organizatë nacionale e shqiptarëve të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, i cili kishte për detyrë të përfshinte në gjirin e vet masat shqiptare — të gjithë shqiptarët e ndershëm rreth një trupi dhe të punonte për ngritjen e tyre politike, kulturo-simnore dhe kombëtare në një shkallë më të lartë, të fitonte besim me vetvete dhe t'u ndihmohej për orientim në rrugën më të mirë të ardhmërisë.

II

Kongresi Themelues i Frontit të Përbashkët Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë u bë në Beograd prej 5—7 gusht të vitit 1945. Në këtë Kongres u formua *Fronti Popullor i Jugosllavisë*. Në Kongres diskutuan edhe delegatët nga Kosova e Metohia, Fadil Hoxha dhe Ali Shukriu. Kjo është hera e parë që delegatët nga Kosova

* Pjesa e Parë e këtij punimi është botuar në numrin 13—14 të revistës »Kosova — Kosovo«, Prishtinë 1985, 141—157.

të paraqiten në tribunën e kongreseve në Jugosllavi. Fadil Hoxha në diskutimin e vet shtoi: »Ju flas në emër të një populli, i cili ka qenë më i robëruari dhe më së shumti i shtypur, bile edhe më shumë, në emër të popullit, i cili i është nënshtruar likuidimit fizik, që do të thotë ju flas në emër të shqiptarëve të Kosovës — Metohisë. Për 22 vjet të sundimit të klikës hegjemoniste serbomadhë populli shqiptar nuk ka jetuar asnjë ditë në liri. Pas kapitullimit të Jugosllavisë dhe ardhjes së okupatorit, shovinizmi që e nxitën hegjemonistët serbomëdhenj dhe klikat shqiptaromëdha dhe më shumë u zhvillua. Popujt tanë pa fije faji ndaj njëri-tjetrit, të mashtruar nga okupatori e klikat çetnike e balliste, filluan luftën kundër njëri-tjetrit. Kjo luftë mori fund tragjikisht dhe të tre popujt do të shfaroseshin sikur të mos ishte Partia Komuniste e Jugosllavisë, e cila e ngriti zërin për luftë të armatosur kundër okupatorit dhe tradhtarëve të të gjitha llojeve me parullën e »vëllezërimit e të bashkimit«.

Lufta Nacionalçlirimtare ishte e vetmja shpëtimtare e popujve tanë. Si të gjitha viset e Jugosllavisë, ashtu edhe popujt e Kosovë-Metohisë e filluan Luftën Nacionalçlirimtare kundër okupatorit, në fillim më pak e më vonë u zhvilluan duke përfshirë masat e gjera popullore. Sot në fshatin më të largët fshatarët e kanë organizatën e frontit të vet. Sot shqiptarët e Kosovë-Metohisë ndihen të lirë dhe plotësisht të barabartë me popujt e tjerë të Jugosllavisë.

Për herë të parë në histori popujt tanë zgjedhin në mënyrë të lirë pushtetin e vet nga njerëzit më të mirë dhe më të ndershëm. Pushteti përbëhet me shumicë nga shqiptarët, por marrin pjesë edhe serbët edhe malaziasit. Pushteti i këshillave popullore, të cilët populli mund t'i ndërrojë, ashtu siç i ka zgjedhur vetë, ai e ndien si mënyrën më të mirë të qeverisjes në mënyrë që vendi i shkatërruar nga armiku më mirë të organizohet dhe të rindërtohet.

Shqiptarët e Kosovës dhe të Metohisë formuan Komitetin Shqiptar, si organizatë politike shqiptare, e cila ka për detyrë që të populli shqiptar të zhvillojë të gjitha virtytet dhe vetitë që e kategorizojnë dhe e ngrisin si popull të lirë. Komiteti është futur në Frontin Popullor dhe në punën e vet gëzon ndihmën e plotë të Frontit. Shqiptarët e Kosovë-Metohisë sot flasin dhe shkruajnë në gjuhën e vet amtare, me këtë gjuhë që po flas midis Beogradit liridashës. Me qindra shkolla dhe kurse analfabetike janë hapur në Kosovë e Metohi, ku shqiptarët, të rinj dhe të vjetër, i kanë shpallur luftë paditurisë, ku mësojnë me kënaqësi gjuhën e bukur të Skënderbeut dhe të Bajram Currit, mësojnë gjuhën e gjyshërve të vet. Shqiptarëve për herë të parë në histori u garantohej e drejta për tokë, pronësi dhe punë. Nuk ka më shqiptarë që frikohen se do të vdesin nga uria dhe se do të përdoren si robër, siç janë përdorur deri tash. Shqiptarët e Kosovës e të Metohisë e dinë se këto të drejta nuk i fituan nga qielli. Këto të drejta i fituan në luftë kundër okupatorit. I fituan në Luftën Nacionalçlirimtare bashkë me vëllezërit serbë dhe malazias, bashkë me popujt vëllezër të Jugosllavisë, bashkë me popullin vëlla të Shqipërisë demokratike të Enver Hoxhës. Nëpërmes gjakut të qindra mijëra viktimave të shqiptarëve, serbëve e malaziasve, nëpërmes shtëpive të djegur

u çimentua vëllazërimi e bashkimi i popujve tonë. Kosova e Metohia nuk është më mollë e grindjes ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë, që do ta dëshironin reaksioni serbomadh dhe shqiptaromadh. Ajo më nuk është monedhë për kusur, përkundrazi, ajo është ndërtesë e fortë me themel të shëndoshë. Njëherësh është edhe urë e vëllazërimit më të fortë e popujve të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë.

Ne, popujt e Kosovë-Metohisë, jemi të vetëdijshëm se çdo gjë që kemi sot (liria, buka e barazia) është meritë e Partisë Komuniste, e cila e ka organizuar luftën e popujve të Jugosllavisë nën parullën e vëllazërimit-bashkimit, tuboi masat e gjera popullore kundër okupatorit dhe tradhtarëve të vendit. Ne, shqiptarët e Kosovë-Metohisë, në fitoren dhe lirinë e fituar që e gëzojmë sot, borxhin më të madh ia kemi birit më të madh të popujve të Jugosllavisë, mikut më të madh, mësuesit, udhëheqësit, dhe organizatorit, shokut Tito. Për këtë të gjithë popujt tanë, me të gjitha forcat e veta janë për forcimin e Frontit Popullor, sepse me këtë do të kontribuojnë për forcimin e Frontit Popullor, të Jugosllavisë⁷.

Ali Shukriu, delegat nga Kosova e Metohia, në diskutimin e tij theksoi: »Shoku Mareshal, Shokë dhe shoqe, në historinë e popujve të Kosovës e Metohisë, shumë herë këta popuj shërbyen si monedhë për të gjitha ato parti dhe grupe politike, të cilat me ndihmën e tradhtarëve të popullit punuan që të vinin në pushtet gjatë të të gjitha regjimeve antipopullore të Jugosllavisë së Vjetër, shpesh duke i shfrytëzuar si tërësi, ose individualisht dhe duke thelluar antagonizmin dhe mërinë, duke shfrytëzuar njërin kundër tjetrit dhe të gjithë së bashku. E Vetmja Parti, e cila në mënyrë konsekuente dhe pandërprerje që gjatë tërë kohës së ekzistimit të Jugosllavisë së Vjetër mbrojti interesat e shqiptarëve e të popujve të tjerë, ishte Partia Komuniste e Jugosllavisë. Popujt tanë të Kosovës e të Metohisë, sidomos populli shqiptar, shohin në Frontin Popullor, në të cilin Partia Komuniste është më e forta dhe temel i sigurt, garancinë e mundësinë që të realizojë dëshirat e veta dhe të sigurojë lirinë e barazinë me të gjithë popujt e tjerë të Jugosllavisë.

Organizatat e Frontit Popullor te ne përfshin të gjitha organizatat antifashiste, sikurse edhe në vendet e tjera të Jugosllavisë. Në Frontin Popullor është edhe Komiteti Nacional i Shqiptarëve, si organizatë e shqiptarëve dhe është pjesë përbërëse e Frontit, me detyrë që sa më shpejt dhe në mënyrë më efikase t'i mundësojë popullit shqiptar ngritjen politike kombëtare në bashkësi me popujt e tjerë të Jugosllavisë. Të gjitha këto organizata në Frontin Popullor kërkojnë linjën unike politike. Frontin popujt tanë e kanë pranuar si formë më të përshtatshme të organizatës politike, përmes së cilës në mënyrë më të sigurt mund të ngrihen në pikëpamje politike e kombëtare. Parimet e propozuara të Statutit të Frontit Popullor, që plotësisht i përgjigjen, do t'i mundësojnë Frontit Popullor te ne që si tërësi të forcohet bashkë me organizatat

⁷ Arkivi i Jugosllavisë, Shënimet stenografike të Kongresit.

e tjera antifashiste dhe me Komentin Shqiptar dhe përbrenda të forcojnë Frontin e të kryejnë detyrat që shtrohen para nesh. Ky është garancion që popujt tanë nëpërmes Frontit t'i realizojnë të gjitha ato detyra që shtron Programi i Frontit, të cilin ne e pranojmë dhe për realizimin e tij do të punojmë me të gjitha fuqitë e popujve tonë në Kosovë-Metohi».²⁸

Fronti Popullor në Kosovë-Metohi, në kuadër të të cilit vepronte edhe Komiteti Nacional i Shqiptarëve të Kosovës dhe të Metohisë ishte i gatshëm t'i realizonte detyrat, të shprehte aspirata dhe t'i plotësojë dëshirat e popujve të Krahinës së Kosovës dhe të Metohisë. Njëherësh, ai pranonte Programin e Frontit Popullor të Jugosllavisë, me të cilin bashkohej në Kongresin Themelues të tij. Nga ana tjetër, me Program sajohej baza për ngritjen politike dhe afirmimin kombëtar, sidomos të shqiptarëve, të cilët deri në këtë kohë nuk gëzonin lirinë dhe barazinë, kurse Komiteti Nacional i Shqiptarëve, si organizatë politike e tyre në kuadër të Frontit Popullor, ishte bazë reale për ngritjen politike dhe kombëtare të shqiptarëve.

Pas formimit të Frontit Popullor të Jugosllavisë, si organizatë politike masive unike, ishin krijuar parakushtet për sigurimin e fitores. Problemi themelor, për të cilin duhej të deklarohet populli, ishte deklarimi për *republikë* ose *monarki*. Kjo çështje u shtrua edhe në Mbledhjen e Dytë të AVNOJ-it, por atëherë mbreti vetëm u suspendua dhe u vendos që kjo çështje të shtyhej për më vonë. Me marrëveshjen Tito — Shubashiq, parashihej që deklarimi i popullit të bëhej pas çlirimit të vendit përmes organizimit të zgjedhjeve të lira. Me marrëveshjen Tito — Shubashiq ishte paraparë që listës së delegatëve për Mbledhjen e Dytë të AVNOJ-it t'i bashkoheshin edhe deputetët e zgjedhur më 1938 për Parlamentin e Mbretërisë së Jugosllavisë, por vetëm ata që gjatë okupimit të vendit nuk kishin bashkëpunuar me nazifashistët dhe që nuk ishin vlerësuar si tradhtarë të popullit. Kështu e vazhdoi punën Mbledhja e Tretë e AVNOJ-it, e cila u shndërrua në *Kuvend të Përkohshëm Popullor* më 10 gusht të vitit 1945. Kuvendi miratoi ligje të rëndësishme si: Ligjin mbi Kuvendin Kushtetues, Ligjin mbi shoqatat dhe tubimet, Ligjin mbi shtypin, Ligjin për reformën agrare dhe kolonizimin, Ligjin mbi gjyqiet e shumë ligje të tjera.

Më 22 gusht të vitit 1945 u miratua Ligji për zgjedhjen e deputetëve popullorë për Kuvendin Kushtetues. Sipas këtij Ligji, Kryesia e Kuvendit të Përkohshëm Popullor vendosi që zgjedhjet të bëhen më 11 nëntor të vitit 1945. Zgjedhjet duhej të bëheshin për deputetë popullorë për *Kuvendin Federativ* dhe për *Kuvendin e Popujve* që e përbënin *Kuvendin Kushtetues*. Për këtë arsye, më 1 shtator të vitit 1945 u dha edhe Dekreti për shpalljen e zgjedhjeve për Kuvendin Kushtetues. Me këtë u hap fushata parazgjedhore. Sipas Vendimit të Komisionit Zgjedhor Federativ, Krahina Autonome e Kosovë-Metohisë duhej të zgjidhte 14 deputetë për Kuvendin Federativ dhe 10 për Kuvendin e Popujve.²⁹

²⁸ AJ, fondi: SSRNJ, Fascikuli 3.

²⁹ AJ, Odluka Savezne izborne komisije, nr. 8, 4. IX. 1945.

Komiteti Nacional i Shqiptarëve të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit në prag të zgjedhjeve mobilizoi edhe më shumë forcat e veta me qëllim të orientimit dhe përvetësimit të masave që të votonin për kandidatët e Frontit Popullor. Në fund të teorit të vitit 1945 KNSH mbajti mbledhje dhe u miratua Proklamata, me të cilën të gjithë shqiptarët ftoheshin të dilnin në zgjedhje dhe të votonin për kandidatët e Frontit Popullor, për Asamblenë Kushtetuese, duke u bërë me dije se këtë herë me kokrra gome duhet të mbrojnë atë që ishte fituar dhe krijuar deri atëherë dhe vazhdon: »Na shqiptarët e Kosovës e të Metohisë i jemi mirënjohës Frontit Popullor dhe krijuesit të tij, Mareshalit TITO, sepse ata na kanë bërë të mundur realizimin e të drejtave tona, të cilat përpara kurrë nuk i kemi pasë. Na jemi ma se krenar qi, na Shqiptarët e Kosovës e të Metohisë, kemi marrë pjesë aktive me luftën e vet, me punën e vet, me përpjekjet e veta në realizimin dhe përforcimin e vllaznimit e të bashkimit të të gjithë popujve të Jugosllavisë e qi kemi krijuar vllaznim e bashkimin edhe me Serbët e Malazezët këtu në Kosovë e Metohi. Na jemi të kënaqur qi morëm pjesë në përforcimin e pushtetit popullor dhe në sigurimin e rendit Demokratik Federativ Republikan. Na jemi kryenaltë sepse kemi dhanë një numër të madh luftëtarësh për armatën Jugosllave, që kemi ndihmë rindërtimin e vendit t'onë. Na jemi kryenaltë sepse bijt t'onë ma të mirë që i kemi zgjedhë e que na kanë marrë pjesë në përpilimin e ligjëve të reja Demokratike. Na e dimë se dëshirat e Shqiptarëve janë të theksueme në programin e Frontit Popullor e se lufta e puna e Shqiptarëve asht e pa zgjidhur me punën dhe luftën e Frontit Popullor, e se ato janë të pa shkëputëshme. Për neve emni i Titos asht garancija ma e madhja, simboli i dëshirave t'ona. Për këtë arsye çdo Shqiptar e Shqiptare e ndershme, pa kurrfarë dallimi, do të votojnë kësajhere për listën e Frontit Popullor, për listën e Marëshalit T I T O, për kandidatët ma të mirë e ma të aftë«.³⁰

Komiteti Nacional i Shqiptarëve të Kosovë-Metohisë u bëri me dije shqiptarëve se duke votuar për Frontin Popullor, sigurohen të gjitha ato që kishin fituar me luftë dhe gjak dhe në këtë mënyrë e kryejnë detyrën e vet patriotike dhe vazhdon: »A i kemi pasur të drejtat tona në Jugosllavinë e vjetër? JO. E çka kemi fituar në Jugosllavinë e re? Kemi fituar lirinë e vërtetë, barabarsinë e vërtetë me popujt e tjerë të Jugosllavisë, përdorimin e lirë të gjuhës amtare, shkollat në gjuhën amtare, tokën, të cilën na e patën grabitur, lirinë e organizimit, respektimin e traditave tona, të flamurit tonë dhe të zakoneve tona. Me një fjalë, për të parën herë historinë tonë kemi fituar, atë pa të cilën një popull nuk mund të quhet popull.

Na, Komiteti i Shqiptarëve të Kosovës e të Metohisë, i cili është krijuar për lartësimin kombëtar, politik, ekonomik e kulturor të shqiptarëve, i cili deri tash ka punuar mjaft për realizimin e qëllimeve të veta, e që ka arritur suksese të mëdha. Sot qëndrojmë të fortë në mbrojtjen e të gjitha të drejtave të arritura dhe prandaj thërrasim çdo shqiptar e shqiptare që të dalë të marrë

³⁰ »Rilindja«, 2 nëntor 1945.

pjesë ndër zgjedhje, e duke votuar për TITON, për Frontin Popullor dhe kandidatët e tij të rrethit, të kryejë detyrën e vet patriotike. Të gjithë ndër zgjedhje. Ai qi s'del ndër zgjedhje, nuk është shqiptar! Nuk është pasardhës i Skënderbeut, i Bajram Currit, i Emin Durakut, e i të tjerëve! Ai që nuk voton për TITON, ai që nuk është për Frontin Popullor, përlyen flamurin e shenjtë shqiptar!³¹ Komiteti Nacional i Shqiptarëve të Kosovës dhe Metohisë me aktivitetin, agjitacionin dhe propagandën që zhvilloi në fushatën parazgjedhore kontribuoi që shqiptarët të votonin për listën e Frontit Popullor. Kushdo që luhatej në këtë drejtim, mallkohej se nuk është shqiptar — shqiptare, duke iu mohuar edhe e drejta që të jetë pasardhës i heronjve kombëtarë: Skënderbeut, Bajram Currit, Emin Durakut e të tjerëve dhe se ai e përlyen flamurin e shenjtë kombëtar shqiptar.

Komiteti Nacional i Shqiptarëve të Kosovës dhe të Metohisë luftë dhe punë të madhe bëri që të binte popullin që të lejonte daljen e grave dhe të vajzave me të drejtë vote në zgjedhje. Kjo ishte punë e rëndë, ngaqë duhej të thyhej tradita, e nga ana tjetër femrat ishin të mbuluara (në çarçafë dhe ferexhe). Mosdalja e femrave shqiptare në zgjedhje ishte humbje e madhe, sepse gati 50 përqind e popullsisë nuk do të votonte, e po të bëhej kështu, lista e Frontit Popullor nuk do të fitonte shumicën. Mirëpo, puna e bëri të veten dhe gratë, ashtu të mbuluara, votuan për listën e Frontit Popullor. Kështu, deputetë për Kuvendin Kushtetues të Jugosllavisë — *Kuvendin Federativ* nga Krahina Autonome e Kosovës-Metohisë u zgjodhën: Boshko Çakiqi, Xhavid Nimani, Mita Milkoviqi, Ismet Shaqiri, Gjoko Pajkoviqi, Hasan Kryeziu, Gjuro Rapajiqi, Milija Cvetniqi, Rifat Berisha, Pavle Joviqeviqi, Mehmet Hoxha, Dushan Mugosha, Fadil Hoxha dhe Gorolub Popoviqi. Pra, u zgjodhën 14 deputetë, prej tyre 6 ishin shqiptarë dhe 8 serbë dhe malazias. Pra, fituan kandidatët e Frontit Popullor në të gjitha rrethet zgjedhore dhe që sipas rendit, i pari i shënuar, përveç në Vuçiternë, ku kandidat i parë ishte shënuar Rexhep Butovci e nuk fitoi, por fitoi kandidati nga lista plotësuese Gjuro Rapajiqi, por edhe ky ishte kandidati i Frontit Popullor.

Për Kuvendin Kushtetues — *Kuvendi i Ponujve* të Jugosllavisë nga KA e Kosovës-Metohisë, u zgjodhën: Ali Shukriu, Alush Gashi, Hivzi Sulejmani, Sahit Zatriqi, Kurtesh Agushi, Kërsta Filipoviqi, Spasoje Gjakoviqi, Zeqirja Rexha, Mustafë Hoxha dhe Zhivojini Qurçiqi. Pra, u zgjodhën 10 deputetë, prej tyre 7 shqiptarë dhe 3 serbë dhe malazias.

Për Kuvendin Kushtetues të Jugosllavisë nga Krahina Autonome e Kosovës-Metohisë u zgjodhën 24 deputetë, prej tyre 13 shqiptarë dhe 11 serbë dhe malazias.

Fronti Popullor korri fitore në zgjedhjet e 11 nëntorit të vitit 1945 dhe Kuvendi Kushtetues i posazgjedhur miratoi Deklaratën për shpalljen e Republikës. Jugosllavia u shpall Republikë Popullore Federative e popujve të barabartë, me emrin Republika Federative Popullore e Jugosllavisë.

³¹ *Po aty.*

Komiteti Nacional i Shqiptarëve të Kosovës e të Metohisë, krahas punës për rindërtimin e vendit, rëndësi të madhe i kushtoi ngritjes ideopolitike të anëtarëve, forcimit organizativ, ngritjes kulturo-arsimore, emancipimit të femrës, luftës kundër forcave reaksionare, zgjidhjes së çështjeve pronësore dhe të tjera. Në prag të shpalljes së Jugosllavisë Republikë, organi i Frontit Popullor të Kosovës dhe Metohisë, »Rilindja«, botoi artikullin »28 NANDUERI FESTA E FLAMURIT«, ku i informon lexuesit se »Populli shqiptar më i gëzuar se kurrë, më krenar se kurrë, e feston ditën e lirisë — e kremton 33-vjetorin e pavarësisë kombëtare« dhe, duke iu drejtuar shqiptarëve të Krahinës sonë, vazhdon:

»Po me aq gëzim, po me aq lumni, po me aq siguri e festojmë edhe ne, shqiptarët e Kosovës e të Metohisë ditën e 28 Nëntorit. E festojmë, sepse i gëzojmë të gjitha të drejtat që korren popujt e Jugosllavisë në Luftën heroike Nacionalçlirimtare.

Sot jemi plotësisht të lirë e të barabartë me të gjithë popujt e Jugosllavisë. Na është dhënë mundësia të zhvillojmë plotësisht ndjenjat kombëtare. Flamuri kombëtar është i lirë — gjuha shqipe është bërë zyrtare. Janë hapur shkollat shqipe. Kemi Komitetin Shqiptar-organizatën politike të të gjithë shqiptarëve të Kosovës të Metohisë. Në luftën e përbashkët është krijuar vëllazërimi e bashkimi ndërmjet popujve tanë.

Prandej e festojmë me gëzim e knaqësi më të madhe ditën e 28 Nëntorit — përvjetorin e pavarësisë së popullit shqiptar.³² Të gjitha këto ishin rezultat i fitoreve në Luftën Nacionalçlirimtare dhe Revolucionin socialist. Meqë para luftës regjimi borgjez kishte shtypur popullin shqiptar edhe në Shqipëri, kurse Jugosllavia ishte bërë »burg« i popujve, e më së keqi ishte për shqiptarët, organi i Frontit Popullor, »Rilindja«, në artikullin »Jugosllavia e vjetër — burg i popujve«, u rikujton edhe njëherë kushtet e jetës, plaçkitjet, zullumin, shpërnguljen nga trojet e tyre me dhunë për Anadoll, burgosjet, vrasjet dhe ndihmën që i ofruan regjimit tradhtarët e popullit si Kryezezët, Begollët, Dragët, Agushët e të tjerë.

Komiteti Nacional i Shqiptarëve të Kosovës e të Metohisë i kishte shtuar vetes detyrë për ngritjen e nivelit kulturo-arsimor të popullit shqiptar. Që kjo punë të kryhej sa më mirë, pranë KNSH-së u formuan Seksioni për gjuhën, folklorin dhe historinë, i cili vetes i kishte shtuar detyra të rëndësishme. Për këtë arsye me kërkesa të caktuara u drejtohej intelektualëve dhe të gjithë të tjerëve që mund të ndihmonin. Seksioni u bënë me dije se të gjithë e dinë se derisa masat e popullit shqiptar në Kosovë dhe Metohi nuk do të arrijnë në një nivel të zhvillimit kulturor, ata nuk do ta ndiejnë veten të lirë, nuk do dinë të gëzojnë të mirat që ia sjellë e sotmja dhe e nesërmja. Duhet njohur vetveten, duhet të kemi kulturë kombëtare, bazë e rëndësishme e të cilës janë: gjuha, folklori dhe historia e popullit tonë dhe vazhdon:

»Komiteti Shqiptar krijoi Seksionin për gjuhën, folklorin dhe historinë. Detyra që ka ky Seksion është e shenjtë, aq patriotike sa edhe e zorshme të kryhet pa ndihmën e të gjithëve, e mbi të

³² Shih: »Rilindja«, 28 nëntor 1945.

gjitha pa ndihmën e intelektualëve dhe të njerëzve që kanë sado-pak shkollë e dijëni; kjo punë nuk mund të kryhet pa ndihmën e pleqve, që e njohin jetën, zakonet dhe doket e popullit tonë në të kaluarën.³³ Seksioni në lidhje me gjuhën, folklorin dhe historinë shtroi kërkesa, por edhe dha shpjegime se nuk duhej krijuar neologjizma të kota, por duhet përdorur ato fjalë të huaja që i ka pranuar shqipja në Shqipëri. Kjo ishte urgjente, por duhej studiuar edhe probleme të tjera. Kësaj thirrjeje iu përgjigjen gati në të gjitha viset e Kosovës. Punohej me zell të madh. Thesari i madh që u mbledh, iu dërgua Seksionit dhe »Rilindjes«. Në »Rilindje« u botuan këto shpjegime:

1. Në lidhje me gjuhën:

a) kush të mundet me u marrë tash për tash me përkëthimin e temave dhe emrave që përdoren n'aparatin shtetnor dhe n'administratë, të cilat kanë mbetë sidomos nga koha e ish Jugosllavisë dhe që po hyjnë tash mbas çlirimit e këtej.

b) me përkthye termat shkencore, politike, juridike dhe teknike etj. . .

c) me zavendësue çdo fjalë të huej që ka hy pa vend në gjuhën tonë të jetës së përditëshme.

2. Në çështjen e folklores:

a) të mblidhen të gjitha kangët shqipe që këndon populli tue shenuë se në cilin vend të Krahinës këndohen.

b) të mblidhen fjalët e urta, cash e lashet (gjeze e gjezë).

c) të shkruhen përrallat, tregimet e ndryshme dhe bestytnitë (sypesticionet).

ç) të shkruhen zakonet e shqiptarve të secilit vend të Krahinës sonë, si dhe lojnat e dëfrimet popullore.

3. Në çështjen e historisë:

a) të mblidhen të gjitha librat ose të nxirren pjesë prej librash që flasin për historinë e popullit shqiptar të Kosovës dhe Metohisë.

b) të mblidhen letra, dokumenta, harta e tjerë që gjinden ndër familjet e patriotve të cilët kanë qenë në lëvizje të ndryshme të popullit shqiptar në Kosovë e Metohi.

c) patriotët pleq që i kanë jetue lëvizjet e së kaluemes dhe njofin jetën e njerëzvet që kanë qenë figura historike si Bajram Currin etj., duhet të shkruajnë për kujtimet e tyre, për jetën e burrave në za etj.

Këtu duhet me dijtë se çdo dokument, çdo tregim çdo interpretim i ngjarjevet ka vlerë historike, pa marrë parasysh tendencën e tij. Që të gjitha propozimet në lidhje me të gjitha pikat që parashtrohen në këtë thirrje na i shkruani nevet, kështu që mbas nji shqyrtimi nga ana e komisioneve kompetente gjithshka do të vehet në dukje me anën e shtypit.³⁴ Me këtë u hap rruga për studimin e gjuhës, të folklorit dhe të historisë kombëtare. Kjo ishte

³³ Shih: »Rilindja«, 6 janar 1946.

³⁴ *Po aty.*

rezultat i LNÇ-së dhe përparësi që afronte ndërtimi i marrëdhënieve socialiste.

Komitetet shqiptare të rretheve rëndësi të madhe i kushtuan ngritjes së nivelit arsimor dhe kulturor. Punë e madhe duhej të bëhej për përfshirjen e fëmijëve në shkollë. Në Konferencën e Komitetit Shqiptar në Istog, me qëllim që t'i bindte shqiptarët, Haxhi Eshrefi — hoxhë nga rrethi i Istogut, delegatëve u drejtohet: »Feja, jo vetëm që na e lejon shkollimin, por edhe na e urdhëron. Njeriu duhet të mësojë që prej djepit e deri në varr. Mos i merrni në qafë evladët tuaj, por dërgoni në shkollë«...³⁵ Në Gjakovë konferenca me prindër mbaheshin për çdo muaj me qëllim që të shtoheshin numri i nxënësve dhe që vijimi të ishte i rregullt. Gjendje gati e ngjashme ishte edhe me disa rrethe të tjera, por kishte rrethe ku konservatorizmi ishte më i madh dhe rezultat i kësaj ishte numri më i vogël i nxënësve nëpër shkolla. Mirëpo, që gjendja të ishte e tillë, ndikonin edhe kushtet e tjera. Komitetet shqiptare nëpër rrethe dhe vende bënin edhe lëshime e gabime, duke mos e kuptuar se si duhej të veprohej. Për këtë arsye KNSH-ja i Kosovës dhe i Metohisë nëpërmjet artikullit të botuar në »Rilindje« me titull »Si duhet të veprojnë komitetet shqiptare në luftimin e zakoneve të këqija«, vinte në pah se »komitetet shqiptare kanë marrë mbi vete një mision të lartë të shpejtësojnë dhe të lehtësojnë zhvillimin kombëtar, politik dhe kulturor të shqiptarëve të Krahinës sonë, dhe në këtë drejtim kanë korrë mjaftë suksese. Mejtëpet e errësirës dhe të çkombëtarizimit po mbyllen, e në vend të tyre po lindin shkollat e reja popullore, të cilat do të edukojnë qytetarë të shëndoshë, të vetëdijshëm dhe të aftë në shërbim të atdheut tonë. Nëpër katunde po bëhen martesat pa shitblerje. Me dhjeta gra po i heqin çarçafët dhe si njerëz të lirë e shikojnë dritën e diellit duke marrë pjesë në rimëkëmbjen e ndërtimit e përgjithshëm. Me mijëra shqiptarë e shqiptare posa kanë mësuar të shkruajnë e të lexojnë, mijëra të tjerë po i ndjekin kurset analfabete. Zakoni i hakmarrjes po zhduket, të gjakësuarit po vëllazërohen e miqësohen ndërmjet tyre. Fryma e re përparimtare gjithnjë më tepër po hyn në katundet shqiptare. Por, të gjitha këto janë vetëm hapat e parë të zhvillimit, nevojitet edhe shumë punë e përpjekje për t'u arritur qëllimi«. Pas kësaj, në artikull shpjegohet se komitetet shqiptare, me qëllim që të luftohen në mënyrë sa më efikase të gjitha pengesat, e në mesin e tyre edhe zakonet propanike, po largohen nga qëllimi i vet dhe me masat që po marrin, po hyjnë në kompetencat e punës së organeve të pushtetit popullor, siç janë konfliktimi i pasurisë, internimi i meshkujve, dërgimi në punë të detyrueshme dhe dënime në të holla. Të gjitha këto u vlerësuan si metoda pune të gabuara, edhe pse qëllimi ishte i mirë. Nga kjo shihet se komitetet ishin bërë organe legjislativë e ekzekutive dhe u vlerësua: »Për një organizatë popullore, siç është Komiteti Shqiptar, këto metoda për zgjidhjen e problemeve janë krejtësisht të huaja. Këso metodash kanë përdorur turqit, që u munduan me shekuj të na turqizonin me zor; serbomëdhenjtë, të

³⁵ »Rilindja«, 25 janar 1946.

cilët mendonin se mund të na serbizonin, duke na detyruar me zor të flisnim serbisht. Me të gjitha këto ne mbetëm shqiptarë se shqiptarë dhe e flasim gjuhën tonë. Por, me këtë nuk duhet të themi se nuk nevojitet edhe marrja e masave ndëshkimore. Në bazë të ligjeve tona, duhet të luftohet kushdo që pengon zhvillimin dhe përparimin tonë.

Por, puna kryesore është që masat shqiptare me vetëdije, të bindura që veprimi i tyre është i drejtë, të ecin rrugës së re. Kur themi masat, na mendojmë për popullin, shtresat e gjera të tij, për shumicën e tij, e jo për disa të zgjedhur që gjenden në vende udhëheqëse në komitete, e që janë të gatshëm të pranojnë çdo ide përparimtare, as për një grusht reaksionarësh, të cilët nuk do të binden kurrë. Kur themi duhet të bindet populli, duam të themi se duhet t'i shpjegohet mirë dëmi që i vjen nga zakonet e këqija, siç është ai i gjakut, i shitjes së vajzave; nga mosinteresimi për shkollimin e fëmijëve; të demaskohen sistematikisht elementët e ndryshëm reaksionarë, që duan të pengojnë rrugën ndërtimit të një ardhmërie më të mirë. Masat duhet të kuptojnë se duhet shkuar vullnetarisht rrugës së re. Masave të gjera të popullit duhet t'u bëhet e qartë se nuk kanë parë ditë, nuk do të mund të bëjnë jetë më të mirë derisa mos të shkëputen njëherë e përgjithmonë nga e kaluara e zezë.³⁶ Nga ky orientim shihet se kërkoreshin masa të karakterit moral: të mos flitej me njerëz të tillë, të mos lidhej miqësi me ta, të mos ndihmohen, të bojkotohen, të merren edhe masa ekonomike: as mos t'u shitej as mos të blihej prej tyre. Kurse, për kërkesat që në konferenca shtroheshin, kërkohej të paraqiteshin në formë të rezolutave dhe t'u dërgoheshin organeve të pushtetit, të cilat do të duhej të zbatoheshin nëse janë në përputhje me ligje. Pra, nga komitetet kërkohej ndikimi moral dhe politik në masat popullore dhe, nga ana tjetër, t'u ndihmohej organeve të pushtetit popullor.

Komiteti i Shqiptarëve për Kosovë e Metohi më 15 prill 1946 në Shtëpinë e Kulturës në Prizren bëri mbledhjen e vet, në të cilën morën pjesë delegatët e komiteteve nga të gjitha rrethet e Kosovës. Mbledhjen e shpalli të hapur Fadil Hoxha, kryetar, kurse Xhavid Nimani, sekretar, paraqiti raportin e punës dhe pas diskutimit u përcaktuan detyrat për punë në të ardhmen. Në raport gati u përsëritën rezultatet e punës, që ishin trajtuar në mbledhjen e Frontit një ditë më parë, por u veçuan edhe rezultatet që kishte arritur KNSH-ja. Njëherësh u vlerësua se në punën e vet Komiteti Shqiptar kishte pasur edhe lëshime: ishin formuar komitetet shqiptare edhe nëpër lagje të qyteteve, edhe pse ishte e panevojshme, meqë në çdo qytet ekzistonte komiteti i vendit, ishin formuar komitetet shqiptare edhe në ato vende ku jetonin vetëm shqiptarët (ngaqë Komiteti kishte për qëllim të lidhte shqiptarët sa më ngushtë në Frontin, ishte e panevojshme që atje ku Frontin e përbënin vetëm shqiptarët të formohej edhe komiteti shqiptar), pastaj në fillim ishte e nevojshme të formohej agjitropi i KNSH-së, por tash duhej të merrnin pjesë në agjitropin e Frontit, sepse ai ish-

* »Rilindja«, 17 mars 1946.

te i përbashkët, mandej KNSH-ja kishte përfshirë edhe disa njerëz politikisht të papërshtatshëm dhe se popullit duhej t'i shpjegoheshin më shumë ligjet.³⁷ Nga këto shihet se edhe udhëheqjes më të lartë të KNSH-së nuk i ishin të qarta disa çështje rreth formimit, organizimit, qëllimit dhe punës së komiteteve. Vërtet, KNSH-ja ishte organizatë politike masive e shqiptarëve, anëtarët e të cilit anëtarësoheshin në mënyrë kolektive në Frontin Popullor. Kjo do të thotë se kishte pranuar Statutin dhe Programin e Frontit. Njëherësh, anëtarët e Komitetit ishin edhe anëtarë të Frontit. Pra, punonin në kuadër të Frontit, por edhe shumë çështje i trajtonin dhe i zgjidhnin në Komitete. Pastaj votonin për kandidatët e Frontit. Çështje e pazgjidhur në formë statutare kishte mbetur puna e organizatave themelore. Në viset ku popullsia ishte e përzier (shqiptarë, serbë dhe malazias) formoheshin komitetet shqiptare, me qëllim që t'i trajtonin dhe t'i zgjidhnin ato probleme që ishin specifike për popullin shqiptar, por për ato vise ku jetonin vetëm shqiptarë kërkoheshin të mos formoheshin komitete, por të punonin vetëm shoqatat e Frontit. Kështu lindën edhe dilemat e para për organizimin dhe punën e komiteteve shqiptare. Kërkesa e shtruar që të mos formoheshin organizatat themelore, është e lidhur me ndarjen e komiteteve nga masa. Kjo është e lidhur edhe me pagimin e anëtarësisë. Në fillim anëtarët e KNSH-së paguanin edhe anëtarësinë. Më vonë kjo u ndalua, ngaqë paguhej anëtarësia për Frontin Popullor. Në këtë mënyrë KNSH-ja edhe materialisht ishte e lidhur me Frontin, sepse mjetet e nevojshme për agjitacion dhe propagandë ndaheshin nga Fronti, kurse nga marsi i vitit 1946 kjo punë kryhej nga komisioni i përbashkët i KNSH-së dhe i Frontit.

Ky ishte hapi i parë në rrugën e njësimt të KNSH-së me Frontin Popullor, përkatësisht shkrirjen e të parit në të dytin. Lidhur me këtë, delegati i Frontit Popullor, Dushan Mugosha, para delegatëve të KNSH-së shtroi: »Komiteti Shqiptar është krijuar që të jetë shtylla më e fortë e Frontit Popullor në Kosmet; programi i Komitetit është program i Frontit, por Komiteti Shqiptar i ka edhe disa veçori të vetat, si, p.sh., luftimi i zakoneve të këqija të shqiptarët, zhvillimi kulturor e nacional i shqiptarëve e të tjera.«³⁸ Nga ky mendim shihet se fillon zhveshja e KNSH-së nga petku politik — organizatë politike masive e shqiptarëve të Kosovës e të Metohisë dhe në plan të parë luftën kundër zakoneve të këqija dhe zhvillimin kulturor, por ende ruante elementin e rëndësishëm të luftës për afirmimin kombëtar të shqiptarëve. Njëherësh u kërkua që Komiteti të shpjegonte se çdo të thotë kombësi e çka fe, ngaqë masat shqiptare ende këto nocione nuk i kishin të qarta.

Delegatët në Konferencë shtruan nevojën për një punë më të organizuar në ngritjen e nivelit kulturo-arsimor dhe sigurimin e kushteve për punë. Kështu, Komiteti Shqiptar i Rrethit të Prizrenit vendosi që të ngrihej një ndërtesë në vendin ku ishte mbajtur Lidhja e Prizrenit dhe atje të hapej biblioteka e Komitetit Shqiptar të Kosovës, për të cilën ishin mbledhur libra dhe do të

³⁷ »Rilindja«, 1 maj 1946.

³⁸ *Po aty*.

vendosej përmendorja e kryetarit të Lidhjes së Prizrenit, Abdyl Frashërit, e cila ndodhej në qendër të qytetit.³⁹ Kurse delegati i rrethit të Llapit shtroi kërkesën që mundësisht të dërgohej ndonjë mësues në ato vise, sepse në 150 fshatra shqiptare⁴⁰ nuk kishin asnjë shkollë dhe asnjë mësues. Konferenca shtroi para komiteteve këto detyra: luftën për arsimin dhe zhvillimin kulturor i masave të gjera shqiptare (ndihma për hapjen e shkollave, kurseve, shtypit); përpjekjen për mbylljen e mejtepeve, mbledhjen e folklorit, luftimin e zakoneve të këqija (luftën kundër hakmarrjes, shitjes së vajzave, kthimin e gruas së vëllait, ferexhen e të tjera), në ndërtimin e shtëpive të kolonistëve shqiptarët duhej të punonin më me zell etj.⁴¹ Për kryerjen e këtyre detyrave komitetet shqiptare duhej ta bindnin popullin, e pastaj punët të kryheshin me vullnetin e tij. Që këto punë të kryheshin me sukses, komitetet shqiptare nëpër rrethe dhe vende, në konferenca e tubime kërkonin prej anëtarëve të vet të zotoheshin se detyrat do t'i kryenin me sukses, madje kërkohej të deklaroheshin se e dhanë *besën shqiptare*.⁴² Kjo pastaj përcillej nëpër fshatra dhe atje lidhej besa. Kështu u kryen shumë punë që me forma të tjera do të ishte shumë vështirë t'u dilej në krye. Ato familje që nuk pranonin kërkesat e Komitetit Shqiptar liçiteshin.

Komitetet shqiptare organizuan në mënyrë masive popullin për pjesëmarrje në garat e Një Majit⁴³ me qëllim që të plotësoheshin kërkesat për mobilizimin e tërësishtëm të popullsisë dhe në këtë drejtim u arritën rezultate në të gjitha fushat e jetës.

Seksioni për gjuhë, folklor dhe histori i KNSH-së i propozoi Komitetit Krahinor të Shqiptarëve që të miratonte vendimin për

³⁹ Shih diskutimin e Ismet Shaqirit në Konferencë më 15 prill 1946. Njëherësh po konstatojmë se kjo është përpjekja e parë për ruajtjen e monumenteve kulturo-historike të traditës së popullit shqiptar pas çlirimit të Kosovës-Metohisë në nëntor të vitit 1944. Kjo punë u krye me rastin e kremtimit të 100-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, qershor 1978.

⁴⁰ Edhe pse sate komuna e Podujevës administrativisht nuk e trashëgoi territorin e rrethit të Llapit, megjithatë, numri i fshatrave është jo i saktë.

⁴¹ Si shën. 27.

⁴² Shih: Vepriartaria e Komitetit Shqiptar: Ferizaj, Gjakovë, Gjiilan, Vuçiternë, Mitrovicë, Podujevë, Dragash, Suharekë dhe Istog. »Rilindja«, 20 prill 1946; 17 maj 1946.

⁴³ Në konferencën e Komiteteve Shqiptare të rrethit të Mitrovicës u pranua njëzëri propozimi i Sekretariatit mbi planin e garave të Një Majit. U dha fjala që medoemos do të plotësohet ky plan brenda kohës së paraparë. Plani i garave të Një Majit përmban:

- 1) të mësojnë shkrim e lexim 700 shqiptarë e shqiptare,
- 2) t'i dërgohen 20 artikuj fletore »Rilindja«,
- 3) të përfshihen në organizata antifashiste 100 shqiptarë e shqiptare,
- 4) të hapen edhe tri shkolla shqipe,
- 5) të jepen 500 orë pune për Partinë Komuniste,
- 6) të zbulohen 30 gra,
- 7) të mos mbetet asnjë pllëmbë toke e papunuar,
- 8) të sigurohej gelqere për nevojat e 400 shtëpive, dhe
- 9) të organizohej aksioni për dorëzimin e të arratisurve.

Në frymën e garave të Një Majit ftohen të gjitha komitetet shqiptare të Kosmetit: shqiptarët e Kosmetit dhe shqiptarët e Maqedonisë, që të bëjnë gara me Komitetin Shqiptar të Rrethit Mitrovicës sa i përket planit të sipërm. »Rilindja«, 17 mars 1946.

nxjerrjen e një reviste. Ky propozim u miratua dhe me rastin e Festës Ndërkombëtare të Punës — Një Majit, filloi të botohej »PËRPARIMI«, revistë e Komitetit të Shqiptarëve të Kosovë-Metohisë. Përmbajtja⁴⁴ e revistës ishte nga fusha të ndryshme. Kjo revistë, me ndërprerje të kohëpaskohshme, botohet edhe sot dhe luajti rol të rëndësishëm në trajtimin e problemeve politike, shoqërore, kulturore dhe shkencore. Gati të gjithë punëtorët e afirmuar politiko-shoqërorë dhe shkencorë kanë qenë ose janë edhe sot bashkëpunëtorë të saj dhe aty botuan punimet e para shkencore.

Përmbajtja është shënuar në kopertinën e parë, kurse në vend të faqes titullare është dhanë fotosi i Generalisimus Stalinit. Revista u shtyp në Shtypshkronjën e Shtetit në Prizren. Përveç kësaj reviste, Komiteti botonte edhe libra të tjerë, si përmbledhje punimesh dhe broshura të ndryshme të karakterit politik dhe propagandues.

Fushata zgjedhore për Kuvendin Kushtetues të Republikës Popullore të Serbisë i mobilizoi organizatat politiko-shoqërore në Krahinë që të forcoheshin edhe në pikëpamje organizative, të aktivizoheshin komisionet për agjitacion dhe propagandë, të luftonin për ngritjen ideopolitike dhe kulturo-arsimore të masave të gjera popullore. Të gjitha këto kishin një qëllim-progresin e përgjithshëm të të gjithë popujve të Kosovës e të Metohisë: shqiptarëve, serbëve dhe malaziasve. Luftë e madhe bëhej për arsimin e popullit shqiptarë, nga mesi i të cilit kishte më shumë analfabetë. Për këtë qëllim Drejtorati i Arsimit të Këshillit Popullor të Krahinës Autonome të Kosovës dhe të Metohisë përgatiti *Abetaren e parë* në gjuhën shqipe për kurset *kundër analfabetizmit*, e hartuar nga arsimtarët e Drejtoratit të Arsimit. Abetarja, përveç shkronjave, kishte edhe tekste të tjera në gjithsej 58 faqe. Abetarja u botua në 50.000 ekzemplarë dhe u shtyp në Shtypshkronjen Shtetërore në Prizren.⁴⁵ Abetarja mundësoi që shumë më lehtë të punohej në kurse. Teksti merret edhe si thesar i kulturës dhe i arsimit për shqiptarët e kësaj Krahine. Për ngritjen kulturo-arsimore rol të rëndë-

⁴⁴ »Përparimi«, nr. 1, Prizren, 1 maj 1946, kishte këtë përmbajtje:

1. Intervista e J. V. Stalin me korrespondentin e »Pravdës« në lidhje me fjalimin e Vinston Çerçillit,

2. Një Maji — festë ndërkombëtare e punëtorëve,

3. Parathanje e librit të Dimitrije Tucoviqit »Srbija i Arbanija« (Milovan Gjilas).

4. Kremljini — Vjershtë — (Lame Kodra),

5. Shoqnja kulturalë jugosllave — shqiptare (Mehmet Hoxha),

6. Ra n'Berlin Ushtria e Kuqe — këngë popullore.

7. Pak fjalë mbi biografinë e Bajram Currit e Shpella e Dragobisë (Zekerija Rexha),

8. Të marin shembull nga herojt e popujvet t'onë Bora Vukmirovic e Ramiz Sadiku (Ismet Shaqiri).

9. Shkolla fillore në regjimin demokratik (Arsimtari).

⁴⁵ Me qëllim që të botohen sa më shumë libra në gjuhën shqipe, më 1 mars të vitit 1946 formohet »Shtëpia Botuese Shtetërore« me seli në Prizren. Aty u botuan librat dhe broshurat e para në gjuhën shqipe në Kosovë e Metohi pas çlirimit.

sishëm luajtën Radio-stacioni — Prizreni e më vonë Prishtina, Teatri, universitetet popullore, gazetat e revistat, gazeta muri, shoqëritë kulturo-artistike, shoqatat dhe klubet sportive.⁷ Të gjitha këto kishin për qëllim ngritjen e përgjithshme të popujve të kësaj Krahine.

Për popujt e Kosovës e të Metohisë kishte rëndësi miratimi i ligjit mbi martesat, i ligjit mbi blerjen e drithit dhe i ligjit mbi nacionalizimin e ndërmarrjeve ekonomike private. Fronti Popullor i Krahinës sonë kishte për detyrë që sa më mirë t'ia shpjegonte popullit përmbajtjen dhe rëndësinë e tyre.

Ligji mbi martesat kishte rëndësi të madhe, sidomos për shqiptarët, si të fesë islame, si të asaj krishterë. Martesa më parë bëhej me pëlqimin e prindërve e jo me pëlqimin e vajzës dhe të djalinjve. Ligji ndalonte poligaminë dhe gruas i kthente dinjitetin. Nga ana tjetër, krijonte mundësi për çlirimin e gruas. Deri me nxjerrjen dhe miratimin e këtij ligji kurorëzimi dhe shkurorëzimi të shqiptarët bëhej në bazë të Shejrrjatit, kurse shkurorëzimit të shqiptarët katolikë nuk lejohej fare. Prandaj, kërkohej që «çdo shqiptar që ia do të mirën popullit të vet dhe dëshiron ngritjen e jetës së tij, çdo aktivist i komiteteve shqiptare, i Gruas Antifashiste, Rinisë Popullore ka për detyrë t'u shpjegojë masave shqiptare përmbajtjen e Ligjit dhe dobritë që rrjedhin nga zbatimi i tij, të ndihmojë sa më shpejt çlirimin e femrës shqiptare... Nga kjo rrjedh vetiu se ai që pengon çlirimin dhe zhvillimin e femrës shqiptare është me dashje ose padashje — por, efekti mbetet i barabartë — armik i shtetit tonë të ri, pra edhe i vetë popullit shqiptar.»⁸ Më këtë Ligj ndalohej edhe martesat në moshën më pak se 18 vjet dhe martesat në afërsi gjaku të drejtpërdrejtë, siç vepronin më parë Begollët e Pejës, por edhe ndonjë tjetër edhe në vijën e tërthorë deri në brezin e tretë inklusiv. Njëherësh, përmbante edhe kujdesin e barabartë të prindërve për fëmijë.

Puna e organizuar krijoi mundësi për politizimin e masave që do të thotë të kuptojnë se çka është ajo që afronte PKJ nëpërmjet Frontit Popullor. Armiku afronte luftën vëllavrasëse, nacionalizmin, shovinizmin, irredentizmin, hakmarrjen, shtypjen nacionalë dhe klasore, dhunën e të tjera. PKJ dhe Fronti Popullor afronin ruajtjen e fryteve të LNÇ-së dhe kultivimin e tyre, vëllazërimin e bashkimit, bashkëjetesën, barazinë, lirinë dhe afirmimin kombëtar, çlirimin e klasës punëtore nga eksploatimi, reformën agrare dhe kthimin e tokës fshatarëve që u ishte marrë nga regjimi ant

⁷ Radiostacioni në gjuhën shqipe kishte këtë skemë të programit javor: 20 konferenca, 21 emisione lajme, 3 emisione kulturore, 1 emision për Komitetin Shqiptar dhe 3 emisione me këngë popullore. Kurse programi mujor për punën organizative politike masive kishte: 4 emisione për FAG-un, 4 emisione për rininë, 4 emisione për pionierë, 4 emisione për Frontin Popullor dhe 4 emisione për Sindikatën. Shih, «Përparimi», 2, Prizren, 1946, fq. 22.

⁸ Gjerësisht për punën e tyre shih: Dr. Fehmi Pushkollli, *Lëvizja Revolucionare e Sindikatave dhe Lidhja e Sindikatave të Kosovës 1919—1944*, fq. 346—447.

⁹ Ali Shukriu, *Rëndësia e Ligjit të ri të martesës për shqiptarët e Kosmetit*, «Përparimi», nr. 2, 1946, 25.

popullor i Jugosllavisë së Vjetër, u afronte pushtetin popullor, të drejtën për arsim dhe kulturë në gjuhën amtare, çlirimin dhe emancipimin e femrës, nxjerrjen e saj nga errësira shekullore dhe të gjitha të drejtat e tjera njerëzore. Që të shpjegoheshin të gjitha këto dhe të kuptoheshin mirë nga populli, u bë punë intensive dhe e mundimshme në të gjitha organizatat e Frontit Popullor. Mirëpo, puna ideopolitike e pandërprerë dhe rezultatet e veta. Fryt i ngritjes ideopolitike të masës ishin sukseset që u arritën në të gjitha aksionet punuese për rindërtimin e vendit, për stabilizimin politik dhe forcimin e organeve të pushtetit popullor, puna për arsimin e masës popullore etj.

Nga e gjithë kjo që u tha mund të përfundojmë se Komiteti Nacional i Shqiptarëve të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit në periodën e rindërtimit të Krahinës luajti rol të rëndësishëm në ngritjen ideopolitike, kulturo-arsimore dhe afirmimin kombëtar të shqiptarëve.

Këshilli Popullor i Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë, në bazë të Ligjit mbi Planin dhe në bazë të Kushtetutës së RP të Serbisë, në mbledhjen e bërë më 21 shtator 1947 miratoi Vendimin për *Planin Pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë popullore të Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë për Vjetët 1947 — 1951*.⁴⁹ Plani ka hyrjen dhe tri pjesë të përcaktuar në 33 nene. Aty shpjegohet se në bazë të rendit të ri shoqëror dhe shtetëror të RFPJ-së dhe të zgjidhjes së drejtë të çështjes nacionale, sukseseve të arritura në periudhën e rindërtimit dhe të ndërtimit të vendit në periudhën e pasluftës dhe me bashkimin e masave popullore të personifikuara politikisht në Frontin Popullor, si fuqi themelore shoqërore për rindërtimin e ndërtimin dhe për realizimin e detyrave të Planit Pesëvjeçar, përcaktohej edhe drejtimi i zhvillimit të Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë, i cili do të evitojë prapambetjen ekonomike të Krahinës dhe pabarazinë e degëve ekonomike të saj. Klikat reaktionare të ish-Jugosllavisë, duke shtypur popujt dhe duke u mohuar çdo të drejtë shqiptarëve, edhe pse Krahina dispononte pasuri të mëdha natyrore e katandisen në mjerim ekonomik e shoqëror. Pas ngadhënjimit në LNÇ u formua pushteti popullor edhe në Kosovë-Metohi, duke u krijuar kështu parakushtet për mënjanimin e prapambetjes ekonomike, shoqërore e politike dhe për një zhvillim të gjithanshëm. Komiteti Nacional i Shqiptarëve të Kosovës e të Metohisë dha kontribut të rëndësishëm për përmbushjen e detyrave që shtronte plani pesëvjeçar. Posaçërisht u dallua në krye të detyrave në punë vullnetare dhe për përmbushjen e detyrave në ngritjen e nivelit kulturo-arsimor.

Komiteti Nacional i Shqiptarëve të Kosovës e të Metohisë kontribut të veçantë dha për emancipimin e femrës shqiptare, sidomos për heqjen e çarçafit dhe të peçës. Në këtë drejtim duhet të përmendet Rezoluta për ndalimin e peçës dhe të çarçafit e Këshillit Popullor Krahinor, e miratuar më 9 janar 1951, që iu dërgua Presidiumit të Kuvendit Popullor të Serbisë që të miratonte

⁴⁹ Këshilli Popullor i Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë 1943—1953, Prishtinë, 1955, 243—274.

Ligjin. Këtë aktivitet të filluar më parë e vazhdoi Fronti Popullor. Prandaj, në Plenumin e Këshillit Krahinor të FP të Kosovës-Metohisë,⁵⁰ të bërë në Prishtinë më 11 janar 1951, edhe pse Plenumi trajtoi Vendimin e Këshillit Kryesor të Serbisë, lidhur me riorganizimin e Frontit Popullor dhe Planin e veprimtarisë ekonomike për vitin 1951, në fund të punës së Plenumit iu dërgua telegram Presidiumit të Kuvendit Popullor të RP të Serbisë, me të cilin kërkohet miratimi i Ligjit për ndalimin e bajtjes së çarçafit dhe të peçës. Në Mbledhjen VIII të rregullt të Kuvendit Popullor të RP të Serbisë u miratua Ligji mbi ndalimin e bajtjes së peçës dhe të ferexhës. Arsyetimin para deputetëve, në emër të Këshillit Legjislativ, e bëri Fadil Hoxha, i cili theksoi se lëvizja më e gjerë në Kosovë e Metohi ka filluar më 1947 në organizatat lokale dhe të rretheve të FAG-ut dhe të Komitetit të Shqiptarëve të Kosovës-Metohisë dhe pas një aktiviteti të gjerë për heqjen e çarçafit dhe të peçës miratuan rezoluta: Komiteti i Shqiptarëve të Kosovës e Metohisë, Këshilli Krahinor i FAG-ut dhe Këshilli Krahinor i Frontit Popullor. Kuvendi Popullor i Serbisë miratoi një Rezolutë për heqjen e çarçafit e të peçës, me të cilën e përkrahu lëvizjen e filluar dhe fitoi përkrahjen edhe nga viset e tjera, ku jetonin myslimanët, prandaj më 1950 edhe e miratoi Ligjin, i cili, përveç të gjitha të mirave të tjera, në radhë të parë është human.

Komiteti Nacional i Shqiptarëve të Kosovës e të Metohisë dha kontribut të rëndësishëm edhe për demaskimin e Rezolutës së Byrosë Informative mbi gjendjen në Partinë Komuniste të Jugosllavisë. Me këtë vërtetuan se janë për politikën e Partisë Komuniste të Jugosllavisë të prirë nga shoku Josip Broz Tito, me të cilën u sigurohej ngritja kulturo-arsimore dhe afirmimi kombëtar i shqiptarëve të Kosovës e të Metohisë. Njëherësh, treguan vetëdijen e lartë patriotike ndaj vendit tonë dhe për ruajtjen e pavarësisë dhe të integritetit territorial.

Konferenca Krahinore e Frontit Popullor të Kosovës e të Metohisë e bërë më 7 e 8 mars të vitit 1948 miratoi konkluzionet, të cilat kishin rëndësi të posaçme për orientimin e mëtejshëm të punës edhe të Komitetit Nacional të Shqiptarëve të Kosovës e të Metohisë. Në pikën 7 të konkluzioneve, ndër të tjera, thuhet: »Nëpërmjet Komitetit Shqiptar të zhvillohet një punë kulturo-arsimore sa më e gjërë ndër masat shqiptare«.⁵¹ Komiteti Nacional i Shqiptarëve, si organizatë politike masive e shqiptarëve, vepronte në kuadër edhe të Frontit Popullor. Në Konferencën e Dytë të KNSH-së, të bërë më 12 janar 1948, Fadil Hoxha mbajti referatin për punën kulturo-arsimore të shqiptarëve, në të cilin theksohet se KNSH-ja i vuri vetes detyrë të parë: çështjen e ngritjes dhe të zhvillimit të kulturës dhe arsimit të popullsisë shqiptare në Krahinë, pastaj luftës kundër shovinizmit, forcimit të vëllazërimit e të bashkimit duke demaskuar politikën e armikut dhe të luftës kundër vesave dhe paragjyqimeve të trashëguara nga koha e robërisë, du-

⁵⁰ Në këtë Plenum Nijazi Maloku u zgjodh sekretar i Këshillit Krahinor të Frontit Popullor për Kosovë e Metohi.

⁵¹ Shih: »Rilindja«, 31 mars 1948.

ke luftuar kështu prapavijën e parullave: »Kështu ma ka lanë baba, po kështu do t'ja la djalit« »Shqiptarit nuk i duhet shkolla, pse kjo ja prish fenë«⁵² dhe të ngjashme.

Komiteti i Shqiptarëve në luftë kundër analfabetizmit gjatë vitit 1947 arriti që nëpër kurse të aftësonte për shkrim dhe lexim 24.262 burra dhe gra. Mirëpo, në vitin shkollor 1947—1948 nuk u organizuan kurse në 135 fshatra dhe në shumë të tjera ishin me organizim të dobët.

Për arsimimin e popullit rol të rëndësishëm luajtën gazetat dhe revistat. Kështu »Rilindja« shpërndahej në 3.000 ekzemplarë, »Zëri i Rinisë« në 4.200 ekzemplarë, »Gazeta e pionierit« në 4.500 ekzemplarë, »Përparimi« në 2.500 ekzemplarë. Po kështu ndikoi edhe »Buletini i Gruas Antifashiste«. Gjatë vitit 1947 tirazhi i përgjithshëm arrinte në 200.000 ekzemplarë. Përveç tyre, u botuan edhe disa libra, si: Josip Broz Tito: »Lufta për çlirimin e Jugosllavis«, V. I. Lenini: »Taksat në natyrë dhe të tjera«. Në këtë kohë theksohej nevoja e angazhimit të Komitetit të Shqiptarëve për mbledhjen e folklorit të pasur shqiptar.⁵³ Këto ishin rezultate që arriti KNSH-ja në ngritjen kulturo-arsimore të popullit shqiptar në Kosovë gjatë vitit 1947. Në fund të Konferencës së Dytë të KNSH-së u miratua Rezoluta,⁵⁴ në të cilën u theksuan detyrat e KNSH-së edhe në fushën e arsimit dhe të kulturës. Rezultatet që u arritën në arsimin e popullit shqiptar shihen nga kjo tabelë:

LIKUIDIMI I ANALFABETIZMIT

Viti shkollor	MËSUAN SHKRIM-LEXIM		
	m.	f.	gj.
1944/45	2100	78	2178
1945/46	15484	1170	16654
1946/47	19316	2671	21987
1947/48	20635	9766	30401
1948/49	19588	15560	35148
1949/50	14346	17441	13787
Gjithsej: ⁵⁵	91469	46686	138155

Nga këto të dhëna, kur bëjmë një krahasim me numrin e përgjithshëm të votuesve shqiptarë, shihet se për të mësuar shkrim-lexim morën pjesë gati gjysma e popullsisë. Prej vitit 1946 deri më 1950 u botuan 47 tituj të teksteve shkollore me një tirazh prej 905.000 ekzemplarësh në gjuhën shqipe. Ndërsa libra dhe broshura prej vitit 1945 deri më 1950 u botuan 143 tituj në 947.750 ekzem-

⁵² »Rilindja«, 24 janar 1948.

⁵³ AK, Fondi: Fronti Popullor, K-7/1948.

⁵⁴ U botua si fletë e posaçme në »Rilindje«, 24 janar 1948; »Përparimi«, nr. 12, Prishtinë, 1948, 24—28.

⁵⁵ AK, Fondi: Fronti Popullor K-10-11/1950.

plarë në gjuhën shqipe. Në vitin 1950 në gjuhën shqipe botoheshin edhe këto gazeta dhe revista: »Rilindja«, dy herë në javë me tirazh 11.000 ekzemplarë, »Zani i Rinisë«, një herë në javë me tirazh 4.000 ekzemplarë, »Gazeta e pionierëve« një herë në muaj me tirazh 17.000 ekzemplarë, »Ndërtuesi« një herë në muaj me tirazh 1.500 ekzemplarë, »Jeta e re«, dymujore, me tirazh 3.000 ekzemplarë. Përveç tyre, kontribut të rëndësishëm për arsimin e popullit shqiptar dha edhe Theatri Popullor Krahinor. Njëherësh vepruan edhe shoqërit kulturo-arsimore që shfaqnin programe edhe në gjuhën shqipe. Të gjitha këto ishin rezultat i angazhimit edhe të Komitetit Nacional të Shqiptarëve të Kosovës e të Metohisë.

Komiteti Nacional i Shqiptarëve të Kosovës e të Metohisë që nga viti 1950 dal ngadalë filloi të zhveshej nga detyra që u shtrua me rastin e formimit të tij në vitin 1945. Veprimtaria e Komitetit të Shqiptarëve filloi të përqëndrohej në një Komision për zhvillimin e gjuhës, të folklorit dhe të historisë së popullit shqiptar. Ndërsa komitetet e shqiptarëve nëpër rrethe filluan të merren kryesisht me punë kulturo arsimore dhe luftën kundër zakoneve prapanike të shqiptarëve. Me këtë formë të veprimitarisë punuan edhe dy vjet. Pas kësaj filloi shuarja e veprimitarisë së tyre dhe të gjitha çështjet shtroheshin në organizatën e Frontit Popullor, përkatësisht nga viti 1953 në Lidhjen Socialiste të Popullit Punues të Kosovës e të Metohisë. Për këtë arsye udhëheqja e organizatave politiko-shoqërore dhe organet e pushtetit popullor vendosën që në vend të komisionit të mëparshëm të formohen Instituti Albanologjik me seli në Prishtinë. Ky institut veproi një kohë të shkurtër dhe pastaj u shua veprimtaria e tij. Mirëpo, edhe më tutje mbeti nevoja për studimin e kulturës dhe të historisë së shqiptarëve. Prandaj, më 1967 riformohet Instituti Albanologjik me seli në Prishtinë, i cili punon edhe sot.

Dr. Fehmi Pushkoll

LA CONSTITUTION DU COMITE NATIONAL DES ALBANAIS DE LA KOSOVA ET SES ACTIVITES 1945—1947

R é s u m é

Le Comité Central du Parti Communiste de la Yougoslavie approuva la décision pour la constitution du Comité National des Albanais de la Kosova et de la Metohia. Le devoir pour la constitution du Comité fut confié au Comité Régional du Parti Communiste de la Yougoslavie pour la Kosova et la Metohia. La Conférence Constitutive du Comité National des Albanais de la Kosova et de la Metohia eut lieu à Prishtina les 27 et 28 mars 1945. C'est ainsi qu'il fut constitué le Comité National des Albanais de la Kosova et de la Metohia. Fadil Hoxha fut élu président du Comité National des Albanais. La constitution du Comité National des Albanais est un des événements très importants dans l'histoire du peuple albanais de la Kosova et du Rrafshi i Dukagjinit. Sa constitution caractérise le mieux la grandeur de la victoire durant la Lutte de Libération Nationale contre l'occupant

fasciste et ses collaborateurs. C'est ainsi qu'on peut expliquer et vérifier l'appel du PCY pour la Lutte de Libération Nationale adressé à tous les peuples de la Yougoslavie le 4 juillet 1941.

L'activité du CNA fut retentissante dans la période 1945—1947. Le Comité travaillait dans la formation idéologique, politique, éducative et culturelle des Albanais de la Kosova et de la Metohia. Le Comité avait son organe — la revue »PËRPARIMI«, qui joua un rôle important dans l'application des devoirs que le Comité demandait à ses membres et surtout pour la mobilisation des Albanais dans la reconstruction du pays et l'accomplissement des devoirs ressortissant du Premier Plan Quinquenal de la construction de la Province Autonome de la Kosova et de la Metohia et de la Yougoslavie. Le Comité National des Albanais de la Kosova et de la Metohia joua un rôle très important dans l'enseignement et dans la formation des Albanais, surtout dans l'émancipation des femmes et dans leur formation scolaire. Il faut souligner particulièrement, dans ce sens, l'engagement du Comité dans la proscription du voile (dont les femmes musulmanes se couvraient le visage) et du tcharchaf. Il s'engagea aussi pour la participation des Albanais dans tous les organismes politiques et sociaux afin de leur affirmation nationale.

